

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT			
MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY			
Njësia Drg Org. Jedin Org. Unit	03	Nr. Prot Br. Prot Prof. No.	3008
Nr. Izdava Broy stranica No. pages	37	Datim Date	26.03.24
PRISHTINE A			NO.1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë - Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy

DATË/A:	26.03.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Znj. Leonita Shabani Mullarama, u.d. Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Shkelzen Kuqi, u.d. Udhëheqës i Departamentit të Integritimit Evropian dhe Koordinimit të Politikave.
CC:	Znj. Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë; Znj. Anyla Beqa, Shefe e Kabinetit të Ministres;
NGA/OD/FROM:	Znj. Kaltrina Shurdhaj, Udhëheqëse e Divizionit për Koordinim të Politikave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për aprovimin e Planit Strategjik Institucional të Ministrisë së Ekonomisë për vitet 2024-2026

E nderuar Znj. Leonita Shabani Mullarama,

1. Çështja:

Në kuadër të procesit të planifikimit të Ministrisë së Ekonomisë është hartuar Plani Strategjik Institucional për vitet 2024-2026.

Ky plan përfshin aktivitetet e propozuara nga të gjitha departamentet dhe njësitë e ME-së por fokus të veçantë kanë sektorët që mbulon Ministria e Ekonomisë siç janë energjia, TIK, minierat dhe monitorimi i ndërmarrjeve publike.

2. Plani është hartuar në përputhje me dokumentet:

- Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026;
- Dokumentet Strategjike Sektoriale;
- KASH 2024-2026.

3. Bashkëlidhur gjeni dokumentin e planit për aprovim.

MINISTRIA E EKONOMISË

Drafti Plani Strategjik Institucional 2024-2026

1. Operacionalizimi i objektivave specifike të ME-së

Nr.	Objektiva specifike	Objektiva operationale	Arsyetimi	Institucioni përgjegjës
1.	Përmirësimi i kornizës së politikave dhe legjisacionit në sektorin e energjisë	Zhvillimi i politikave në sektorin e energjisë	<p>Si anëtare e Komunitetit të Energjisë, Kosova obligohet që të përmbush kërkesat që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë, me theks të veçantë tek transpozimi dhe adaptimi i të gjitha dispozitave ligjore konform direktivave evropiane, apo "acqui" të energjisë me theks transpozimin dhe zbatimin e Pakos së energjisë së pastër. Kjo pako përbëhet nga një sërë aktesh legjislativë që rregullojnë Efiçencën e Energjisë (EE), Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), tregjet e energjisë elektrike, menaxhimin dhe administrimin e krizave për furnizim me energji elektrike. Gjithashtu, Kosova është edhe nënshkruese e Deklaratës së Sofjes mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor në vitin 2020, ku është zotuar që deri në vitin 2050 të arrijë emetimet neto zero të CO2.</p> <p>Objektivat e paraqitura në këtë plan qojnë në drejtim të dekarbonizimit të sektorit të energjisë dhe ekonomisë, fuqizimit i të drejtave të konsumatorit, rritjes së nivelit të gjenerimit të energjisë nga BRE, rritjes së efiçencës së energjisë dhe stimulimit të projekteve inovative.</p>	ME
		Monitorimi i zbatimit të politikave në sektorin e energjisë	/	ME

		Harmonizimi i legjislacionit në sektorin e energjisë me EU acquis	Si anëtare e Komunitetit të Energjisë, Kosova obligohet që të përmbysh kërkesat që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë, me theks të veçantë tek transpozimi dhe adaptimi i të gjitha dispozitave ligjore konform direktivave evropiane, apo "acquis" të energjisë me theks transpozimin dhe zbatimin e Paktos së energjisë së pastër. Kjo pako përbëhet nga një sërë aktesh legjislative që rregullojnë Efiçencën e Energjisë (EE), Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), tregjet e energjisë elektrike, menaxhimin dhe administrimin e krizave për furnizim me energji elektrike.	ME
2.	Rritja e pjesëmarrjes së BRE-ve në miks in energjetik	Promovimi i përdorimit të BRE-ve për energjinë elektrike dhe termike	Rritja e pjesëmarrjes së Burimeve të Ripërtëritshme në miks in e energjisë është thelbësore për të arritur objektivat e dekarbonizimit, për të siguruar një tranzicion të drejtë energjetik në Kosovë dhe për të arritur plotësimin e caktuar të energjisë nga BRE 32% i bruto konsumit final të energjisë, deri në vitin 2030 i përcaktuar më Vendimin e Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë, ky objektivi është pjesë bazë për arritjen e çaqeve.	ME
3.	Rritja e efiçencës së energjisë	Zbatimi i masave të efiçencës së energjisë në ndërtesa publike (niveli qendror dhe lokal)	Efiçenca e Energjisë është një nga komponent thelbësore në drejtim të sigurisë së furnizimit me energji dhe është mënyra më e lehtë dhe me kosto efektive për të luftuar ndryshimet klimatike, për të reduktuar kostot e energjisë për konsumatorët dhe për të përmirësuar konkurrencën e bizneseve. Efiçenca e energjisë është gjithashtu një komponent jetik në arritjen e emetimeve neto zero të dyoksidit të karbonit nëpërmjet dekarbonizimit. Objektivat e paraqitura në kuadër të këtij plani kontribuojnë në arritjen e çaqeve, përkatesisht zbatimin e objektiveve shtetërore në fushën e Efiçencës së Energjisë.	ME

	Subvencionimi i masave të Eficiencës së Energjisë në sektorin rezidencial dhe NMVM	<p>Ministria e Ekonomisë ka filluar me subvencionimeve e pajisjeve eficiente pas miratimit të Planit të Veprimit “Zbulja e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike” në shumë prej shtatëdhjetë e pesë (75) mln Euro të ciliat Komisioni Evropian i ka alokuar për Kosovën nga fondet IPA III, ku janë zbatuar dhe do të zbatohen masat si në vijim: Mbështetja e konsumatorëve familjarë, përfshirë konsumatorët në nevojë duke investuar në pajisje shtëpiake eficiente dhe në sisteme të energjisë së ripërtëritshme në instalimin e pajisjeve ngrohëse eficiente; Instalimin e pajisjeve shtëpiake me eficiencë të lartë; Instalimin e sistemeve të energjisë së ripërtëritshme. Si dhe Rritja e eficiencës së energjisë në Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) ku janë mbështatur përmes subvencionimit në: Instalimin e pajisjeve ngrohëse eficiente dhe Instalimi i sistemeve të energjisë së ripërtëritshme.</p>	ME
4. Zhvillimi i politikave të sektorit minerar	Menaxhimi i resurseve minerale të Kosovës	<p>Menaxhimi i resurseve minerale është një aktivitet i integruar i cili identifikon, vlerëson dhe siguron një plan optimal të shfrytëzimit të resurseve minerale, për të prodhuar një produkt cilësor i cili plotëson objektivat e biznesit të ndërmarrjes por dhe kërkesat e konsumatorit, në një mjedis dinamik.</p> <p>Sipas Ligjit për Miniera dhe Minerale (LMM) Nr:03/-163 Neni 74 respektivisht Ligjit Nr:04/L-158 për Ndrshimin dhe Plotësimin e Ligjit bazik neni 45, KPMM është e obliguar që: gjatë tremujorit të fundit të secilit vit kalendarik të përgatit dhe dorëzon në Ministri, Projekt Planin për Menaxhimin e Resurseve Minerale për vitin vijues, i cili duhet të jetë në përputhje me Strategjinë Minerare të Kosovës.</p>	ME

		Zhvillimi i politikave të reja në sektorin minerar	Politikë e re është hartimi dhe miratimi i Strategjisë së re Minerare e Republikës së Kosovës. Ky do jetë dokument strategjik për sektorin minerar që krijon mundësi reale për shfrytëzimin sa më racional dhe zhvillimin e qëndrueshëm të resurseve minerale. Strategjia Minerare përbën kornizën themelore, në bazë të së cilës përcaktohen objektivat dhe prioritetet zhvillimore të sektorit minerar. Strategjia Minerare përcakton politikat dhe masat për zhvillimin e sektorit minerar në dobi të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies sociale.	ME
		Promovimi i aktiviteteve minerare	Promovimi i sektorit minerar përbën një prioritet të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit, përmes të cilës do të vetëdijësohet tregu vendor dhe ndërkombëtar për mundësitë që ofron vendi në zhvillimin e resurseve minerale.	ME
5.	Monitorimi i sektorit minerar	Vlerësimi i Progresit të Strategjisë Minerare	Vlerësimi i Strategjisë Minerare është një proces i rregullt vjetor. Vlerësimi bëhet përmes hartimit të Raportit Vjetor të Progresit. Raportit Vjetor i Progresit lidhet me zbatimin e Strategjisë Minerare për periudhën 2012-2025 dhe përgatitet në përputhje me nenin 73, të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minerat dhe Mineralet si dhe nenit 44, paragrafët 5, 6, 7 dhe 8, të Ligjit Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minerat dhe Mineralet dhe kapitullin 8, paragrafi 8.1 dhe 8.2 të Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025.	ME
		Monitorimi i aktiviteteve minerare në nivel vendi	Monitorimi i aktiviteteve minerare do të bëhet përmes Raportit të rregullt Vjetor me të dhënat për periudhën njëvjeçare me të dhëna të reja nga aktivitetet minerare. Synim i këtij Raporti është përpunimi i të dhënave me qëllim të promovimit të aktiviteteve të sektorit minerar dhe kompletimi i të dhënave.	ME

6.	Zhvillimi institucional dhe kapaciteteve njerëzore	Aftësimi i stafit profesional në miniera mbi implementimin e rregullave teknike të mbrojtjes dhe sigurisë në vendin e punës	ME
7.	Mbrojtja e mjedisit dhe mirëqenies sociale në sektorin minerar	Harmonizimi ndërinstitucional i masave dhe aktiviteteve në trajtimin e gështjeve mjedisore e sociale në sektorin minerar	ME
8.	Infrastruktura digjitale e avancuar dhe e sigurt	<p>Hartimi dhe miratimi i Ligjit për komunikimet elektronike</p> <p>Hartimi i Strategjisë së Kosovës për TIK</p> <p>Hartimi dhe miratimi i Rregullores për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të portofolit të identitetit digjital</p>	<p>Zhvillimet teknologjike, paraqitja e shërbimeve të reja dhe nevoja e rregullimit të relacioneve të tregut e bëjnë të domosdoshme nxjerrjen e ligjit të ri për komunikimet elektronike. Ligji i ri për komunikimet elektronike do të transpozoi Kodin e Komunikimeve Elektronike të BE-së (Direktivës), i cili njëherësh është edhe obligim në proceset integruese të Kosovës drejt BE-së.</p> <p>Pas miratimit të Agjendës Digjitale të Kosovës 2030, vitin e kaluar, si një dokument strategjik horizontal, tani është e nevojshme të hartohet Strategjia e TIK duke përfshirë edhe planin e veprimit si dokument strategjik vertikal.</p> <p>Rregulloria për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të identitetit dixhital është rregulloria e fundit e nevojshme në zbatim të Ligjit Nr. 08/L-022 për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike, pas miratimit të 10 rregulloreve tjera në fund të 2022.</p>

		Krijimi i një pike të vetme informacioni për dhënien e lejeve të nevojshme për ndërtimin e rrjeteve fikse	Krijimi i pikës së vetme të informacionit për dhënien e lejeve për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike është projekt që do të mundësoj zbatimin e Ligjit Nr. 08/L-007 për masat për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë – si kërkesë ligjore.	
		Ndërtimi i Qendres për Ekselencë Digjitale, në ITP – Prizren	Ndërtesa me konsum afër-zero të Energjisë (nZEB) në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren (ITP) në Prizren. Planimetria e ndërtesës përbëhet nga bodrumi, përdhesa dhe kati i parë (B+P+1) me sipërfaqe totale prej 1258m ² . Projekti është në përputhje me SKZH dhe aktivitetet në kuadër të masës.	
9.	Transformimi Digjital i Bizneseve	Krijimi i Qendrave të Inovacionit Digjital (Digital Innovation Hubs)	/	ME
10.	Digjitalizimi i shërbimeve publike	Krijimi i sistemit të eID	Sistemi për identifikimin dhe autentifikimin elektronik – Sistemi eID është sistem i cili do të mundësoj identifikimin dhe autentifikimin elektronik, si dhe nënshkrimin elektronik dhe vulën elektronike, të qytetarëve dhe bizneseve. Zbatimi i identifikimit dhe autentifikimit elektronik do të mundësoj shfrytëzimin e sigurt të shërbimeve elektronike e me këtë do të arrihet edhe shtimi i vazhdueshëm i shërbimeve elektronike, si nga ana e Qeverisë ashtu edhe nga bizneset. Projekti financohet nga IPA dhe sipas planifikimeve zbatimi do të realizohet deri në TM3-2024.	ME

11.	Popullsia me aftësi digjitale dhe ekosistemi inovativ i H&Zh	Trajnimi për të rinj dhe lidhja e tyre me mundësitë e punëve online, përmes programeve KODE dhe IPA 2017	ME
12.	Themelimi i një Ekosistemi të qëndrueshëm të sigurisë kibernetike	Krijimi i CERT-it Sektorial për sektorin e energjisë (ME-KOSTT)	ME
13.	Zhvillimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik me brez të gjerë me çlësi të lartë	Lidhja me infrastrukturë fikse brezgjere e pirgjeve të rrjetit mobil (5G ready)	ME
14.	Përmirësimi i lidhjeve në ndërkombëtare telekomunikacion	Pilotimi i 5G në ITP Prizren, Kosovë	ME
	Një nga objektivat strategjike të Strategjisë së arsimit 2022-2026 – është edhe digjitalizimi i arsimit. Një aktivitet shumë i rëndësishëm për arritjen e këtij objektiwi është edhe ndërtimi i infrastrukturës dixhitale në shkolla dhe lidhja e tyre me KREN e GEANT. Nga viti i kaluar janë në proces e sipër të realizimit lidhja e 100	Një nga objektivat strategjike të Strategjisë së arsimit 2022-2026 – është edhe digjitalizimi i arsimit. Një aktivitet shumë i rëndësishëm për arritjen e këtij objektiwi është edhe ndërtimi i infrastrukturës dixhitale në shkolla dhe lidhja e tyre me KREN e GEANT. Nga viti i kaluar janë në proces e sipër të realizimit lidhja e 100	ME

		shkollave të mesme e fillore, e gjatë këtij viti do të bëhet lidhja e së paku 110 shkollave të tjera.	
15. Hartimi i legjislacionit dhe përputhjen e tij me legjislacionin e BE-së, shqyrtimi i konsistencës me dispozitat kushtetuese dhe ligjore si dhe mbikëqyrja e cilësisë dhe standardet e hartimit të legjislacionit në fushën përkatëse	Menaxhimi i procesit të koordinonimit në hartimin e akteve normative në fushë veprimtarinë e ministrisë	/	ME
16. Menaxhimi i procesit të hartimit të Planit Kombëtar për Zhvillim për Ministrinë, Planit të Punës së Ministrisë, monitorimi dhe raportimi i tyre	Koordinimi i aktiviteteve të planifikimit, monitorimit dhe raportimit të Planit Kombëtar për Zhvillim si dhe Planit vjetor të punës së Ministrisë	/	ME
17. Menaxhimi i proceseve dhe aktiviteteve për realizimin e agjendës Evropiane	Koordinimi i procesit të planifikimit dhe monitorimit të PKIE dhe të Agjendës e Reformave Koordinimi i procesit të planifikimit të projekteve të IPA, WBIF dhe LPP	/	ME
18. Sigurimi i shpenzimit të mjeteve financiare në përputhje me rregullat dhe procedurat buxhetore	Kontrolli i shpenzimit të buxhetit dhe trajtimi i kërkesave në përputhje me ndarjet buxhetore me Ligjin Vjetor të Buxhetit	/	ME
19. Përmirësimi i sistemit të qeverisjes korporative, rritja e transparencës dhe llogaridhënies si dhe përmirësimi i menaxhimit të financave publike, me qëllim të ofimit të shërbimeve cilësore nga NP për qytetarë	Monitorimi i punës së Bordeve të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-ve në zbatim dhe implementim të objektivave dhe politikat zhvillimore të vendosura nga Qeveria Përmirësimi i mbikëqyrjes të NP-së në implementimin e rekomandimeve të Auditimit të jashtëm në raportin e auditimit të pasqyrave financiare të ndërmarrjes Mbështetja financiare për projekte kapitale dhe subvencionimi për ndërmarrjet publike të cilat nuk arrijnë t'i mbulojnë shpenzimet me mjete vetanake	/	ME

20.	Rritja e transparencës dhe llogaridhënies kundrejt publikut	Trajimi i kërkesave për qasje në dokumente publike dhe trajimi i pyetjeve dhe ankesave nga qytetarët dhe mediat	Publikimi me vetiniciativë i dokumenteve publike në web fagen e ministrisë dhe komunikimi i vazhdueshëm me mediat, organizatat joqeveritare dhe qytetarët mbetet njëra ndër objektivat kyçe në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënjes.	ME
21.	Përmirësimi dhe implementimi i politikave të komunikimit brenda ME-së	Promovimi i aktiviteteve të ME-së përmes rrjeteve sociale të ME-së dhe monitorimi i mediave	Më qëllim që komunikimi të jetë sa më efektiv për publikun dhe sa më i shpejtë, përmirësimi dhe implementimi i Politikave të Komunikimit brenda ME-së, do të zhvillohet në vazhdimësi përmes takimeve brenda institucionit si dhe përmes trajnimeve që zhvillohen në vend dhe jashtë tij në fushën e Komunikimit.	ME
22.	Ngritja e vetëdijesimit të operatorëve në zbatim të ligjeve të energjisë dhe pajisjeve nën presion, rregulloret dhe kodeve teknike që derivojnë nga ligjet bazike	Ngritja e nivelit të zbatueshmërisë së ligjeve, rregulloret dhe kodeve të energjisë nga operatorët energjisë dhe pajisjeve nën presion	/	ME
23.	Zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit për nevojat e ME-së	Rritja e konsistencës në mes të planifikimit të prokurimit dhe buxhetit të ministrisë	/	ME
24.	Zhvillimi i aktiviteteve të auditimit të brendshëm për arritjen e objektiveve të ME-së	Vlerësimi i kontrollave të brendshme në të gjitha strukturat e sistemeve në Ministrinë e Ekonomisë	Objektivat e përgjithshme të auditimit përqëndrohen në procese dhe rreziqe të dukshme dhe kanë për qëllim përmirësimin e proceseve të cilat auditohen. Objektivat e përgjithshëm i auditimit ka të bëjë me rishikimin e pajtueshmërisë rregullative. Auditimi i brendshëm përqëndrohet në aktivitetet financiare dhe të kontabilitetit të subjektit, objektivat e auditimit do të jenë të lidhur me besueshmërinë dhe saktësinë e informacioneve financiare, pajtueshmërinë e regjistrave kontabël dhe raporteve financiare me politikën, planet, procedurat, rregulloret, ligjet dhe me rrajet e asetëve.	ME

			Procedurat e auditimit janë mjet për arritjen e objektivave të auditimit.	
25.	Përgatitja e planit vjetor të personelit, në përputhje me procesin e planifikimit buxhetor të ME-së	Menaxhimi i procesit të planifikimit të personelit sipas nevojave të ministrisë dhe identifikimi i nevoja për trajnim	Në konsultim me të gjitha departamentet dhe njesitë e ME-së do të identifikohen dhe plotësohen pozitat e lira të punës.	ME
26.	Mbeshetja e departamenteve dhe njesive përkatëse të ME-së në përgatitjen e përshkrimeve, klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punë	Rishtururimi i Nëpunësve civil aktual dhe miratimi i pozitive e të punës sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Ekonomisë	Struktura organizative e ME-së ka pësuar ndryshime dhe rezulton të ketë ndryshim të pjesshëm edhe të strukturës. Nëpunësit aktual të ME-së duhet të sistemohen në pozitat e parapara në Rregulloren e Brendshme.	ME

2. Objektivat operacionale, treguesit dhe caqet

Objektiva operacionale	Departamenti përgjegjës	Treguesi	Caget			
			Baza	2024	2025	2026
Zhvillimi i politikave në sektorin e energjisë	Departamenti i Energjisë	Numri i dokumenteve të politikave (strategji, planeve dhe programeve të përgatitura)	2	3	6	/
		Numri i opinionëve për bilancet e energjisë dhe planet zhvillimore të operatorëve	3	7	11	14
		Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të politikave në sektorin e energjisë	2	6	10	14
Monitorimi i zbatimit të politikave në sektorin e energjisë	Departamenti i Energjisë					
Harmonizimi i legjislationit në sektorin e energjisë me EU acquis	Departamenti i Energjisë	Numri i ligjeve të aprovuara	1	5	/	/
		Numri i koncept dokumenteve të aprovuara	/	1	/	/
		Numri i akteve nënligjore të aprovuara	2	4	10	14
		Numri i ankandeve të BRE	/	1	2	/
		Numri i studimeve	/	2	/	/
Promovimi i përdorimit të BRE-ve për energjinë elektrike dhe termike	Departamenti i Energjisë					
Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në ndërtesa publike (niveli qendror dhe lokal)	Departamenti i Energjisë	Numri i objekteve	/	20	/	/
Subvencionimi i masave të Efijencës së Energjisë në sektorin rezidencial dhe NMVM	Departamenti i Energjisë	Numri i konsumatorëve rezidencial	10,990	~15,000	/	/
		Numri i NMVM	/	~300	/	/
Menaxhimi i resurseve minerale të Kosovës	Departamenti i Minerave	Hartimi dhe miratimi i Planit të menaxhimit të resurseve minerare	Plani i menaxhimit të resurseve minerare 2024	Plani i miratuar për vitin 2025	Plani i miratuar për vitin 2026	Plani i miratuar për vitin 2027
Zhvillimi i politikave të reja në sektorin minerar	Departamenti i Minerave	Strategjia e re e hartuar dhe miratuar	Strategjia në fuqi 2012-2025	/	Hartimi dhe miratimi i	Zbatimi i strategjisë së re

Promovimi i aktiviteteve minerare	Departamenti i Minerave	Organizimi i Konferencave vjetore për promovim të sektorit minerar	Konferenca vjetore e realizuar për "Gjeoshkencat , roli i tyre në zhvillimin e qëndrueshëm"	Konferenca vjetore e realizuar për "Gjeoshkencat , roli i tyre në zhvillimin e qëndrueshëm"	Konferenca vjetore e realizuar për "Gjeoshkencat , roli i tyre në zhvillimin e qëndrueshëm"	Konferenca vjetore e realizuar për "Gjeoshkencat , roli i tyre në zhvillimin e qëndrueshëm"
Vlerësimi i Progresit të Strategjisë Minerare	Departamenti i Minerave	Hartimi i Raportit të Progresit të Strategjisë Minerare	Raporti i Progresit të Strategjisë Minerare 2022	Raporti i Progresit të Strategjisë Minerare 2023	Raporti i Progresit të Strategjisë Minerare 2024	Raporti i Progresit të Strategjisë Minerare 2025
Monitorimi i aktiviteteve minerare në nivel vendi	Departamenti i Minerave	Raporti vjetor për vitin paraprak lidhur me aktivitetet minerare në nivel vendi	Raporti vjetor	Raporti vjetor	Raporti vjetor	Raporti vjetor
Aftësimi i staffit profesional në miniera mbi implementimin e rregullave teknike të mbrojtjes dhe sigurisë në vendin e punës	Departamenti i Minerave	Numri i trajnimeve të organizuara	0	1	2	2
Harmonizimi ndërinstitucional i masave dhe aktiviteteve në trajtimin e gëshëve mjedimore e sociale në sektorin minerar	Departamenti i Minerave	Zhvillimi i takimeve dhe organizimeve të përbashkëta me institucionet tjera relevante	/	Organizimi i takimeve sipas kërkesave	Organizimi i takimeve sipas kërkesave	Organizimi i takimeve sipas kërkesave
Hartimi dhe miratimi i Ligjit për komunikimet elektronike	Departamenti i TIK	Drafti i projektligjit i finalizuar dhe dërguar për miratim në Qeveri	JO	PO	/	/
Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Kosovës për TIK	Departamenti i TIK	Drafti i Strategjisë i hartuar	JO	PO	/	/

Hartimi dhe miratimi i Rregullores për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të portofolit të identitetit digital	Departamenti i TIK	Drafti i Rregullores për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të portofolit të identitetit digital i finalizuar	JO	PO	/	/
Krijimi i Pikës së vetme informacioni për dhënien e lejeve të nevojshme për ndërtimin e rrjeteve fikse	Departamenti i TIK	Përqindja e zbatimit të kontratës për Pikën e Vetme të Informacionit	0	50	100	/
Ndërtimi i Qendrës për Ekselencë Digjitale, në ITP – Prizren	Departamenti i TIK	Përqindja e zbatimit të kontratës për Ndërtimin e QED e nënshkruar dhe fillimi i zbatimit	0	50	100	/
Krijimi i Qendrave të Inovacionit Digjital (Digital Innovation Hubs)	Departamenti i TIK	Numri i Qendrave të Inovacionit Digjital dhe grupimeve industriale që duhet të mbështesin transformimin digjital të NVM-ve inovative dhe jo-digjitale	0	0	2	/
Krijimi i sistemit të eID	Departamenti i TIK	Sistemi i eID i përfunduar dhe funksional	JO	Po	/	/
Trajnimi për të rinj dhe lidhja e tyre me mundësitë e punëve online, përmes programeve KODE dhe IPA 2017	Departamenti i TIK	Numri i të trajnuarve në fushën e TIK	2600	3900	/	/
Krijimi i CERT-it Sektorial për sektorin e Energjisë (ME-KOSTT)	Departamenti i TIK	eCERT i krijuar dhe funksional	JO	JO	JO	PO
Lidhja me infrastrukturë fikse brezgjere e pirgjeve të rrjetit mobil (5G ready)	Departamenti i TIK	% e banorëve në zonat e populluara të mbuluara nga 5G	/	25	50	65
Pilotimi i 5G në ITP Prizren, Kosovë	Departamenti i TIK	Numri i rritur i rrjeteve private 5G për vertikalet	/	1	2	4
	Departamenti i TIK	Numri i shkollave me infrastrukturë digjitale dhe të lidhura me KREN	44	200	/	/

Ndërtimi i infrastrukturës digjitale në shkollë dhe lidhja e tyre gigabitëshe me KREN dhe GEANT	Departamenti Ligjor	Numri i përgjigjeve të rrjetit mobil të lidhura me infrastrukturë brezgjere (5G Ready)	60	70	/	/
		Piloti 5G i zbatuar dhe funksional	JO	JO	PO	/
Menaxhimi i procesit të koordinimit në hartimin e akteve normative në fushë veprimtarinë e ministrisë	Ligjor	Numri akteve normative të zhvilluara kundrejt atyre të planifikuara në fushë veprimtarinë e ministrisë.	Programi Legjislativ për vitin 2024	5	/	/
		5 Projektligje të planifikuara për hartim dhe miratim (1. Projektligji për Energji, 2. Projektligji për Energjinë Elektrike, 3. Projektligji për Rregullatorin e Energjisë, 4. Projektligji për Efiçencë të Energjisë, 5. Projektligji për Kodin e Komunikimeve Elektronike)				
Koordinimi i procesit të planifikimit dhe monitorimit të PKIE dhe të Agjendës e Reformave	Departamenti i Integritimit Evropian dhe Koordinimit të Politikave	% e zbatimit të PKIE për kapitullin 10 Shoqëria Informativë dhe mediat si dhe kapitullin 15 Energjia	PKIE e realizuar 64% për vitin 2023	PKIE zbatuar sipas planifikimeve	PKIE zbatuar sipas planifikimeve	PKIE zbatuar sipas planifikimeve
		Hartimi i Agjendës së Reformave	/	Agjenda e Reformave e hartuar	Zbatimi i Agjendës së Reformave	Zbatimi i Agjendës së Reformave
Koordinimi i procesit të planifikimit të projekteve të IPA, WBIF dhe LPP	Departamenti i Integritimit Evropian dhe Koordinimit të Politikave	Përgatitja e Projekt propozimeve për IPA dhe WBIF sipas rundeve të aplikimit	Lista e Projekteve Prioritare	Raporti vjetor mbi zbatimin e Projekteve të IPA	Raporti vjetor mbi zbatimin e Projekteve të IPA	Raporti vjetor mbi zbatimin e Projekteve të IPA
		% e zbatimit të PKZH në nivel të ME-së	PKZH e realizuar 56% për vitin 2023	PKZH e zbatuar sipas planifikimeve	PKZH e zbatuar sipas planifikimeve	PKZH e zbatuar sipas planifikimeve
Koordinimi i aktiviteteve të planifikimit, monitorimit dhe raportimit të Planit Kombëtar për Zhvillim si dhe Planit vjetor të punës së Ministrisë	Departamenti i Integritimit Evropian dhe Koordinimit të Politikave	% e zbatimit të Planit vjetor të punës së Ministrisë	Plani vjetor i punës së ME-së për vitin 2023	Plani vjetor i zbatuar sipas planifikimeve	Plani vjetor i zbatuar sipas planifikimeve	Plani vjetor i zbatuar sipas planifikimeve

Kontrolli i shpenzimit të buxhetit dhe trajtimi i kërkesave në përputhje me ndarjet buxhetore me Ligjin Vjetor të Buxhetit	Departamenti për Buxhet dhe Financa	Evitimi i obligimeve pa financim të mjaftueshëm	Ligji i Buxhetit për vitin 2023	ZKA/ZKF 100%	ZKA/ZKF 100%	ZKA/ZKF 100%
Monitorimi i punës së Bordeve të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-ve në zbatim dhe implementim të objektivave dhe politikave zhvillimore të vendosura nga Qeveria	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike	Shqyrtimi i procesverbaletë të mbledhjeve të Bordeve të Drejtorëve/BD dhe Komisioneve të Auditimit/KA të NPQ-ve	12 raporte të rregullta	12	/	/
		Analiza e raporteve tremujore të NPQ-ve lidhur me caqet e vendosura në planin e biznesit dhe buxhetin e Ndërmarrjes të cilat në baza të vazhdueshme monitorohen nga Njësia e NP-ve	4	4	/	/
		Raportimi vjetor për performacën operative dhe financiare të NPQ-ve tek Qeveria për progresin e arritjes së objektivave zhvillimore	1	1	/	/
Përmirësimi i mbikëqyrjes të NP-së në implementimin e rekomandimeve të Auditimit të jashtëm në raportin e auditimit të pasqyrave financiare të ndërmarrjes	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike	Monitorimi i implementimit të Planit vjetor për eliminimin e të gjeturave të Auditorit të jashtëm për NPQ-të	17 Plane vjetore për eliminimin e të gjeturave të Auditorit të jashtëm për NPQ-të	17	/	/

Mbështetja financiare për projekte kapitale dhe subvencionimi për ndërmarrjet publike të cilat nuk arrijnë t'i mbulojnë shpenzimet me mjete vetanake	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike	Mbështetur në ligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës	8 NPQ të mbështetura	10 NPQ	/	/
Vlerësimi i kontrollave të brendshme në të gjitha strukturat e sistemeve në Ministrinë e Ekonomisë	Njësia e Auditimit të Brendshëm	Kryerja e auditimeve sipas planifikimit si dhe atyre me kërkesë të veçantë me aprovim të Ministrisë	4 auditime për vitin 2023	4 auditime	/	/
Rritja e konsistencës në mes të planifikimit të prokurimit dhe buxhetit të ministrisë	Divizioni i Prokurimit	Numri i procedurave të prokurimit që zhvillohen në kuadër të planit të prokurimit për projekte kapitale dhe mallra dhe shërbime	15	20	/	/
Menaxhimi i procesit të planifikimit të personelit sipas nevojave të ministrisë dhe identifikimi i nevoja për trajnim	Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	Hartimi i planit vjetor të personelit, në përputhje me procesin e planifikimit buxhetor të Ministrisë Numri i konkurseve të publikuara dhe zhvillimi i procedurës së rekrutimit Identifikimi i nevojave për trajnim të nëpunësve civil	Numri aktual i të punësuarve është 150 zyrtarë. Numri i pozitave të buxhetuara për vitin 2024 është 202	Plotësimi i 10 pozitave të lira të punës të parapara në Planin e personelit për vitin 2024	Plotësimi i 20 pozitave të lira të punës të parapara në Planin e personelit për vitin 2025	Plotësimi i 20 pozitave të lira të punës të parapara në Planin e personelit për vitin 2026
Rishturimi i Nëpunësve civil aktual dhe miratimi i pozitive të punës sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Ekonomisë	Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	Përfundimi i procesit të rishturimit dhe ri sistemimi i nëpunësve aktual Ofrimi i ndihmës për departamentet dhe njësitë në përgatitjen e përshkrimeve, klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës Miratimi i PDP dhe pozitive në përputhje me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ME	Raporti i komisionit për rishturim; Vendimet e nëpunësve për transferim ri-sistemim të DMZP	Aprovimi i pozitive të punës në ME Përfundimi i procesit të rishturimit në ME	/	/

Promovimi i aktiviteteve të ME-së përmes rrjeteve sociale të ME-së dhe monitorimi i mediave	Divizioni për Komunikim me Publikun	Numri i artikujve në media dhe portale	980	Publikimi i njoftimeve, komunikatave, infografikave dhe materialeve vizive	Publikimi i njoftimeve, komunikatave, infografikave dhe materialeve vizive	Publikimi i njoftimeve, komunikatave, infografikave dhe materialeve vizive
Trajtimi i kërkesave për qasje në dokumente publike dhe trajtimi i pyetjeve dhe ankesave nga qytetarët dhe mediat	Divizioni për Komunikim me Publikun	Numri i kërkesave të trajtuara për qasje në dokumente publike	39	Sipas kërkesave për vitin 2024	Sipas kërkesave për vitin 2025	Sipas kërkesave për vitin 2026
Zbatimi i formës së inspektiveve të bazuara në rrezik dhe zvogëlimi i numrit të inspektiveve	Njësia e Inspektimit të Energjisë	Identifikimi i operatorëve të rinj të energjisë dhe përditësimi i bazës së të dhënave me qëllim të fuqizimit të inspektiveve të bazuara në rrezik	12	Varësisht nga numri i operatorët të rinj të regjistruar	Varësisht nga numri i operatorët të rinj të regjistruar	Varësisht nga numri i operatorët të rinj të regjistruar
Ngritja e nivelit të zbatueshmërisë së ligjeve, rregullore dhe kodeve të energjisë nga operatorët energjisë dhe pajisjeve nën presion	Njësia e Inspektimit të Energjisë	Ngritja e vetëdijesimit të operatorëve në zbatim të ligjeve të energjisë dhe pajisjeve nën presion, rregullore dhe kodeve teknike që derivojnë nga ligjet bazike	253 inspektive	104 inspektive	/	/

3. Plani vjetor i zbatimit

Objektiva operationale	Departamenti përgjegjës	Caku për 2024	Aktivitetet sipas tre mujoreve të vitit			
			TM1	TM2	TM3	TM4
Zhvillimi i politikave në sektorin e energjisë	Departamenti i Energjisë	Finalizimi i Planit Kombëtar për Energi dhe Klimë 2025-2030 dhe hartimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për PKEK 2025-2030	Angazhimi i konsulencës nga GIZ për hartimin e PKEK-së 2025-2030 dhe VSM-në për PKEK-në; Trajtimi dhe adresimi i opinionit/komenteve nga SKE; Dërgimi i draft dokumenteve në konsultim paraprak.	Trajtimi i komenteve nga konsultimi paraprak dhe adresimi i tyre për PKEK-në dhe VSM-në; Dërgimi i dokumenteve PKEK-së dhe VSM-së në konsultim publik.	Trajtimi i komenteve nga diskutimi publik për PKEK dhe VSM; Finalizimi i draftit	Marrja e opinionëve nga MF dhe ZKM; Miratimi në Qeveri.
